



PROGRAMI AVANCOJMË KOSOVËN SË BASHKU –ALTERNATIVA LOKALE THIRRJE PËR APLIKIM RFA-03-AKT-LS

AKT LS përmes Komponentës për Angazhim Qytetar ka për qëllim nxitjen e bashkëpunimit pozitiv dhe konstruktiv ndëretnik midis popullsisë jo-shumicë serbe dhe komunitetit shumicë shqiptarë në të gjitha 16 komunitetet e synuara përmes ofrimit të mbështetjes për aktivitetet e përshtatura për të nxitur bashkëpunimin në mes të komuniteteve të ndryshme etnike. AKT LS fton OJQ-të e regjistruara vendore që të paraqesin kërkesën/aplikimin për organizimin e ngjarjeve kulturore në shkallë të vogël në vlerën deri në 5.000 dollarë amerikanë për GRUPIN 1, mobilizimin e grupeve të marginalizuara, projektet e avokimit dhe të fuqizimit, në vlerë deri në \$ 25,000 për GRUPIN 2, ngritja e kapaciteteve dhe asistencë teknike për qeveritë lokale, OShC-të apo komunitetet në vlerë deri në 50,000 dollarë për GRUPIN 3 dhe iniciativat më të mëdha që synojnë të gjitha apo shumicën e 16 komunave të përfshira në projekt në vlerë deri në 100,000 \$ për GRUPIN 4

Qëllimi i kësaj ftese për aplikim është kontributi drejtë arritjes së objektivave të programit Avancojmë Kosovën së Bashku veçanërisht nr. 1 dhe 3:

1. Përmirësimi i komunikimit autonom horizontal në mes të: (a) komunitetit shqiptar dhe komuniteteve jo-shumicë të Kosovës; dhe (b) QeK dhe komunitetet jo-shumicë;
2. Përmirësimi i mundësive ekonomike në komunitat e synuara;
3. Rritja e efikasitetit dhe kapacitetit të administratave komunale të synuara për t'iu përgjigjur nevojave të të gjithë qytetarëve të tyre.

Informatat per Grantet

RFA përfshin të gjitha informatat e nevojshme për të aplikuar për një grant, megjithatë, pyetjet në këtë RFA duhet të dorëzohen tek:

Agron Selmani, Menaxher për grante
Zyra e projektit Avancojmë Kosovën së Bashku- Alternativa lokale
Sejdi Kryeziu, nr.16, Pejton, Prishtinë, 10000, Kosovë

Telefoni i zyres: 038 249 677/678
E-mail: grants@kcdf.org

Afati i fundit për pyetje është 20 mars 2015 në ora 3:30 pm. Si pyetjet ashtu edhe përgjigjet do të ofrohen për të gjithë aplikuesit deri më 23 mars 2015 ora 3:30 pm.

Organizatrat duhet të tregojnë GRUPIN specifik për të cilin ata janë duke aplikuar në kopertinën e Aplikacionit dhe në pjesën e jashtme të zarfit.

Kopjet fizike të aplikacionit mund të dorëzohen në një nga adresat e mëposhtme:

Zyra e CDF, Agron Selmani
Adresa: 'Sejdi Kryeziu', nr.16, Pejton, 10000, Prishtinë, Kosovë

Zyra e AKTIV, Branislav Nesovic
Adresa: Cika Jovina 3, II/6, Mitrovica e veriut

Ditët informuese me aplikuesit potencial do të organizohen si në vijim:

1. Asambleja Komunale në Pejë, adresa: 'Aleksandër Moisiu' p.n. Pejë më 16 mars, 2015 në ora 10:00
2. Zyra e AKTIV, adresa: Cika Jovina 3, Mitrovica veriore II/6, më 17 mars 2015 në ora 10:00
3. Asambleja Komunale Vushtrri më 17 mars 2015 në ora 14:00
4. Asambleja Komunale Graçanicë më 18 mars 2015 në ora 10:00
5. Shtëpia e Kulturës Klllokot më 18 mars 2015 në ora 14:00
6. Asambleja Komunale Shtërpçë më 19 mars 2015 në ora 10:00

Programi USAID/AKT–LS nuk do të mbulojë shpenzimet e pjesëmarrjes në seancat informuese.

Është thelbësore që ju te vizitoni faqen tone të internetit www.kcdf.org/AKT-LS për Kërkesën e plotë për Aplikime, dokument dhe detaje mbi dorëzimin e Aplikimit tuaj.